



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Duke u bazuar në Strategjinë nacionale për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 0-72 të datës 17.01.2018, Komuna e Prishtinës shpall:

KONKURS

Për plotësimin e pozitave për anëtar të Komitetit Komunal Veprues nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare

Kabineti i Kryetarit

Zyra për Komunitete dhe të Drejtat e Njeriut,

Titulli i vendit të punës: Anëtar i Komitetit Komunal Veprues,

Lloji i Vendit të Punës: Vullnetar (pa kompensim financiar),

Numri i Pozitës: Katër (4) ekzekutues (dy anëtarë të organizatave ndërkombëtare dhe 2 anëtarë të organizatave të shoqërisë civile të fokusuar në përmirësimin e gjendjes të komuniteteve joshumicë),

Kohëzgjatja e emërimit: Tre vite (3), duke u bazuar në Strategjinë nacionale për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, e cila është në fuqi deri në vitin 2021.

Detyrat dhe roli i anëtarit të Komitetit Komunal Veprues:

- Të bashkëpunoj me autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë nacionale për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Prishtinës;
- Të merr pjesë aktive në takimet e Komitetit Komunal Veprues;
- Të monitoroj aktivitetet e parapara në planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;

- Të kontribuojë në iniciimin e miratimit të politikave tjera lokale, të cilat do të kontribuonin në zbatimin e planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;
- Të koordinojë aktivitetet me institucionet e nivelit qendror dhe organizatat e shoqërisë civile për zbatimin e planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;
- Të zhvillon aktivitete me partnerë tjerë për alokime të fondeve për zbatimin e planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës;

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare do të jetë publike dhe transparente. Do të merren parasysh kriteret, si vijon:

- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët punojnë me sukses më shumë se tri (3) vite në fushën e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat kanë programe/projekte të qëndrueshme në fushën e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që monitorojnë aktivitetet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Prishtinës;
- Kandidatët nga radhët e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që kanë njohuri të mjaftueshme për monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe projekteve të caktuara;

Kriteret e kualifikimit për anëtar të Komitetit Komunal Veprues

- Diplomë universitare;
- Përvoja minimale e punës trevjeçare në fushën e përfshirjes së komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare;

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diploma universitare e kualifikimit;
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës që përfaqësojnë;
- Dëshmi të përvojës të punës.

Vetëm kandidatët me kriteret e plotësuar do të ftohen në intervistë.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Diplomat e kandidatëve kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë publikohet në web faqen e Komunës të Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen. Ndërsa, origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **06/12/2018 deri më datën 20/12/2018.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.